






**Data e lindjes: 04. 12. 1979**  
**Vendi i lindjes: Mitrovicë**

 Rr. George Bush Nr. 31,  
10 000 Prishtinë

 +383 38 244 189

 mimoza.ibrani@uni-pr.edu

# Prof. Asoc.Dr. MIMOZA IBRANI

## Prorektore për mësimdhënie dhe çështje për studentë

### PROFILI

---

Studimet themelore i ka përfunduar me notë mesatare 9.45 në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Elektroteknikës, drejtimi Kompjuterikë me Telekomunikacion. Gjatë studimeve është nderuar me çmimin Student i dalluar. Studimet e magjistraturës shkencore i ka përfunduar në vitin 2007, ndërsa punimin e doktoraturës e ka mbrojtur në vitin 2011, para Komisionit vlerësues të përbërë nga profesorë të UP-së dhe Universitetit Concordia, Montreal, Kanadë. Ka përvojë 16 vjeçare në mësimdhënie universitare. Është autore kryesore e shumë punimeve shkencore të publikuara në revista shkencore ndërkombëtare të indeksuara nga ISI dhe Scopus dhe punimeve të prezantuara në konferenca shkencore ndërkombëtare. Ka mentoruar punime të masterit dhe doktoraturës. Shërben në kontinuitet si recenzente e revistave shkencore ndërkombëtare me impakt faktor. Ka udhëhequr me sukses dhe ka marr pjesë në implementimin e disa projekteve shkencore. Ka përvojë të dëshmuar në përgatitjen e projekt propozimeve dhe koordinimin e projekteve ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve në arsimin e lartë, si dhe sjelljen e fondeve në Universitetin e Prishtinës. Ka shërbyer në pozita të ndryshme menaxheriale në Universitetin e Prishtinës. Për 5 vite ka ushtruar detyrëne Drejtores së Zyrës për Zhvillim Akademik në Universitetin e Prishtinës ndërsa 2 mandate ka qenë Prodekane për çështje akademike në FIEK. Në periudha të ndryshme ka shërbyer si anëtare e: Komisionit të studimeve, Komisionit Qendror për Sigurimin e cilësisë, Këshillit Qendror për Studime të Doktoratës, Komisionit drejtues të Universitetit Veror Ndërkombëtar të Prishtinës, Komisionit Këshillëdhënës të Rektorit etj. Nga 1 tetor 2020 është zgjedhur Prorektore për mësimdhënie dhe çështje për studentë.

### PËRVOJA AKADEMIKE

---

- 2004-2012 Asistente në FIEK-UP
- 2012-2017 Profesor asistent në FIEK-UP
- 2017- tani Profesor i asocuar në FIEK-UP

### PËRVOJA MENAXHERIALE

---

- 1 tetor 2020- tani, Prorektore për mësimdhënie dhe çështje për studentë
- 2012- 2020, Prodekane për çështje akademike në FIEK
- 2008-2011 , Drejtoreshë e Zyrës për zhvillim akademik në UP
- 2006-2007, Koordinatore për ECTS në FIEK

### EDUKIMI

---

- 1985-1994 Shkolla fillore, Mitrovicë
- 1994-1998 Gjimnazi “ Frang Bardhi”, Mitrovicë
- 1998-2004 Studimet themelore në Fakultetin e Elektroteknikës ( Dipl. Ing.)
- 2004-2007 Magjistratura shkencore ( Mr.sc.)
- 2008-2011 Studimet e doktoraturës (Dr.sc.)